



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.12.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Seancë dëgjimore me grupet e interesit lidhur me shqyrtimin e projektligjeve "Për kadastrën në Republikën e Shqipërisë" dhe "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë". (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Dritan Bici, Edmond Leka dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Florjon Mima, Lorenc Luka, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Gjetan Gjetani, Lefter Koka dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Teuta Vodo - Zëvendësministre e Drejtësisë
Artan Lame - Drejtor i Përgjithshëm i ALUZINI-t
Edvin Kukunja - Këshilltar i Ministres së Drejtësisë
Ermira Gjeçi - Zëvendësministre e Bujqësisë
Majlinda Bozgo - Përgjegjëse në Sekretariatit Teknik në Komisionin Qeveritar të Tokës/Ministria e Bujqësisë
Lorena Goxhobelli - Këshilltare e Ministrit
Reshit Vorpsi - Shoqata "Pronësi me Drejtësi"

Bledi Stafa – Shoqata e Gjeodetëve të Shqipërisë

Romeo Nazarko - Shoqata e Gjeodetëve të Shqipërisë

Brunilda Laze– Shoqata e Gjeodetëve të Shqipërisë

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Përsëritje, të nderuar kolegë deputetë!

Në fund të javës që kaloi ju kemi njoftuar që përgjatë kësaj jave do të zhvillojmë disa mbledhje të komisionit. Sikundër jeni në dijeni, janë njoftuar dy seanca parlamentare, ditën e enjte dhe ditën e premte, me axhenda të përcaktuara. Sot do të diskutojmë për projektligjin “Për kadastrën në Republikën e Shqipërisë” dhe për projektligjin “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

Përveç të ftuarve nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Bujqësisë dhe ALUIZNI, kanë kërkuar të jenë të pranishëm në komision edhe dy grupe interesi. Gjithashtu, kemi të pranishëm nga Shoqata për “Pronësi me Drejtësi” zotin Reshit Vorpsi, të cilit i uroj mirëseardhjen në komision, si dhe zotin Romeo Nazarko nga “Shoqata e Gjeodetëve”, me të cilin kemi pasur një takim.

Elona, duhet ta kisha përpara se të zhvillohej mbledhja listën me emrat e të ftuarve. Ju kërkoj ndjesë për ngatërresën.

Gjatë javës së kaluar në komision kemi zhvilluar disa takime individuale, por edhe me grupe. Për shembull, me Bledin dhe Brunildën kemi pasur një takim informal në komision, por kemi pasur edhe individë të ndryshëm që na kanë shkruar. Ka edhe disa propozime. Të fundit e kam me *e-mail* në lidhje me një nen, të cilin do ta vë në dispozicion edhe të relatorëve për ta parë. Pra, ka individë, por edhe grupe interesi që kanë paraqitur propozimet.

Zoti Vorpsi, e fillojmë me ju. Më pas do të flasë Romeo Nazarko nga “Shoqata e Gjeodetëve”.

Zoti Vorpsi, mirë se erdhe në komision!

Ju lutem, bëni një prezantim të pozicionit tuaj në shoqatë dhe më pas flisni për ligjin.

Reshit Vorpsi – Quhem Reshit Vorpsi dhe jam sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës “Pronësi me Drejtësi”.

Faleminderit për ftesën!

Për sa i takon projektligjit, më duket se është një përkeqësim i mëtejshëm i pozitave të pronarëve shqiptarë në raport me pjesën tjetër të popullsisë. Ndonjëherë pyes veten nëse pronarët shqiptarë janë qytetarë të dorës së dytë në këtë republikë apo janë njerëz që kanë të drejta. Kjo është gjendja e përgjithshme e secilit që e ka lexuar këtë projektligj. Kjo është ndjenja e parë që i vjen gjithsecilit në momentin që lexon këtë projektligj. Më duket se projektligji ka synim të vulosë dhe t'i japë legjitimitetin gjithçkaje që ka ndodhur në këto 30 vjet në Republikën e Shqipërisë.

Për sa u takon titujve të pronësisë, ka një synim të qartë për të mbyllur pas 30 vjetësh çështjen e ligjit nr. 7501. Është fatkeqësi që pas 30 vjetësh, nga viti 1991 deri sot, ligji nr.7501 të vazhdojë të jetë një kalë beteje në fushata elektorale, sepse, fatkeqësisht, kështu ka qenë.

Çfarë po bëhet me këtë projektligj? Po u jepen tituj pronësie edhe atyre personave që me ligj përfitonin gjysmën e titullit të pronësisë. Po marr një rast për ta ilustruar këtë situatë. Ish-banorët e kooperativave bujqësore, që nuk ishin në marrëdhënie pune me kooperativën bujqësore në atë kohë, sepse ishin të punësuar diku tjetër, sipas ligjit nr.7501 merrnin gjysmën e normës të tokës bujqësore për frymë, kurse me këtë amendim u jepet normë e plotë për frymë. Pse duhet të bëhet kjo gjë? Nëse mund të themi një gjë që ka dështuar me sukses, është Komisioni i Verifikimit të Titujve të Pronësisë. Edhe pse kanë kaluar mbi 10 vjet që është krijuar nuk janë kthyer më tepër se 400 hektarë tokë. Pse? Në 625 000 hektarë tokë bujqësore që janë ndarë, vetëm 400 hektarë kanë qenë në konflikt interesi dhe të dhënë jashtë normës së të drejtës? Tani këto komisione do ta mbyllin veprimtarinë. Gjithkush tjetër, de facto është i legjitimuar në atë parregullsi që ka pasur.

Kthehemi edhe një herë te pronarët shqiptarë.

Ku e shohin veten pronarët shqiptarë për sa i takon vazhdimin të ndarjes së tokës bujqësore? Pronarët shqiptarë do të përfitojnë vetëm atë sipërfaqe toke që do t'u japë pushteti qendror në kuadrin e tokave që do të jepen për kompensimin fizik. Më gjeni një vend në këtë projektligj ku pronarët shqiptarë, që mund të kenë tokat e tyre në një kooperativë të caktuar, të marrin tokat e tyre. Si mund t'i marrin? Nuk ka asnjë mënyrë.

Shikoni projektin e tretë, “pasuritë e pushtetit qendror dhe pasuritë e pushtetit vendor”. Ju e dini më mirë se gjithë të tjerët që të gjithë titujt e pronësisë të dhënë pushtetit vendor nuk ka njeri në botë që mund t'i përdorë për një qëllim tjetër përveç pushtetit vendor. Pra, ato nuk mund të shërbejnë asnjëherë për kompensimin e pronarëve. Pasuritë që i kalojnë pushtetit vendor nuk mund të shërbejnë asnjëherë për kompensimin e pronarëve shqiptarë. Çfarë po ndodh? Dijeni që pushteti vendor po i shfrytëzon mirë këto pasuri.

Për shembull, bashkia e Tiranës ka vendosur që çfarë janë pasuri me titull pronësie “shtet” brenda në qytet, do t'i marrë bashkia e Tiranës. Nëse do të ketë një marrëveshje ndërtimi në atë sipërfaqe, bashkia e Tiranës do të futet me përqindje. Pra, mund të marrë një metër katror tokë shtet, që ndoshta do të shërbente për kompensimin e një pronari dhe thotë që kjo tokë më duhet mua. E jep për ndërtim dhe minimalisht merr për çdo metër katror më tepër se një metër katror. Do të thotë, me termat e tregut, rreth 1500 euro për metër katrorë. Ligji thotë që pronari do të kompensohet dhe në rastin më të mirë do të marrë 660 mijë lekë

për metër katror, por nuk dihet se kur do t'i marrë. Ju e dini fare mirë këtë gjë. Pse nuk duhet të kenë të drejtë, sipas këtij projektligji, pronarët shqiptarë që të kompensohen me tokat e tyre në fashat? Nuk i jap dot një përgjigje kësaj pyetje.

Ju e keni fare të qartë sipërfaqen 23 mijë hektarë tokë që janë dhënë për kompensimin fizik të pronarëve shqiptarë, 23 mijë parcela janë baras me 23 mijë hektarë tokë (është publikuar me vendim të Këshillit të Ministrave), në katër zonat më malore të 4 qarqeve: Elbasanit, Gjirokastrës, dhe dy qarqeve të tjera. Kam pasur fatin të punojë në Ministrinë e Bujqësisë dhe e kam kontrolluar Republikën. Ka fshatra që as emrat nuk ju dihen kur janë lënë tokat për kompensimin e pronarëve. 23 mijë hektarë, 23 mijë parcela. 77% e parcelave janë nën 1 hektarë. Do të shërbejnë këto për kompensimin fizik të pronarëve? Kjo do të thotë të mashtrosh opinionin publik dhe t'i ushqesh pronarët shqiptarë me lugë boshe. Pronarët shqiptarë nuk mund të marrin dot me këtë projektligj që keni përgatitur asnjë kompensim në tokat bujqësore në qoftë se nuk janë prona të pushtetit qendror. Më vjen keq që po flas me një gjuhë të tillë, por duhet të më kuptoni drejt, të nderuar deputetë. Është një gjendje shpirtërore e përgjithshme që nuk të lë mundësi të tjera.

Tani të kalojmë te pjesa e legalizimeve. Dua t'ju tërheq vëmendjen për një gjë, të nderuar deputetë. Ligji i parë i legalizimeve, në nenin 39 të tij parashikonte që kompensimi i pronarëve shqiptarë që do të shpronësoheshin për efekt të legalizimeve, duhet të bëhej brenda 6 muajve nga data e daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave. Në amendimet e mëtejshme të këtij neni të famshëm, në vitet 2009-2010, u vendos një piketë e re, që kompensimi do të bëhej në bazë të ligjit për krijimin e fondit special me këste të barabarta atëherë kur paratë do t'i ketë qeveria. Sot jemi në gjendjen që kemi një ligj që nuk ka detyrim ligjor se kur do të bëhet kompensimi i atyre pronarëve që shpronësohen nga procesi i legalizimit. Ligji parashikon që të gjithë ata pronarë do të kompensohen kur të ketë para qeveria dhe me aq para sa të ketë qeveria, të ndara në këste të barabarta. Shembulli më i qartë është ky. Vendimi i parë i Këshillit të Ministrave që ka dalë për shpronësimet për efekt të legalizimit ka qenë në vitin 2008. A e dini që akoma sot ata persona nuk i kanë marrë paratë? As 70% të shumës kanë marrë pas 10 vjetësh pronarët që do të shpronësoheshin për efekt të ligjit të legalizimeve nga vendimi i parë i vitit 2008. Mendo çfarë mund të bëhet me të tjerët. Kjo nuk e pengon shtetin që përditë të publikojë lista të reja sikur do të shpërndahen iks para për shpronësimet për efekt legalizimi, por asnjëri nuk e di se ku e ka.

Sot ky projektligj i ri ka të njëjtën gjë. Jemi në kushtet që procesi i legalizimit mund të krijojë një gropë të zezë në buxhetin e shtetit shqiptar dhe asnjëri nuk do që ta shikojë realitetin me sy. Pse? Sepse atyre njerëzve, jo vetëm që iu dha e drejta kur pushtuan tokat,

bile i pushtuan tokat me bekimin e qeverive, por sot po u legjitimohet edhe pushtimi i tokave. Sikur të mos mjaftojë kjo, ata persona i blejnë parcelat e tyre ndërtimore me çmime preferenciale. Sipas një studimi që ka paraqitur vetë ALUIZNI, deri në vitin 2013 procesi i legalizimit ka qenë një katastrofë. Një person në proces legalizimi duhet të paguante përafërsisht 5 milionë lekë të vjetra për të marrë një parcelë 300 metra katrorë, që i bie 15 apo 16 mijë lekë për një metër katror. Ky është çmimi mesatar me të cilin ata persona që futen në procesin e legalizimit blejnë një tokë të pushtuar. Çfarë ndodh? E blejnë me këtë çmim, por nëse aty nesër apo pasnesër planifikohet të ndërtohet një rrugë, ai person do të marrë (marrim shembull zonën e Astirit) 330 mijë lekë për metër katror. Kush do ta paguajë diferencën nga 15 mijë lekë në 330 mijë lekë për metër katror? Do ta paguajë taksapaguesi shqiptar. Pse duhet të paguajë taksapaguesi shqiptar dhe të mos e paguajë me çmimet e tregut ashtu siç e ka përcaktuar ai që ka pushtuar tokën? Sepse ai është kërkuesi, është nevojtar. Në kushte të tjera ai do të shkonte në burg. Në këto kushte, përkundrazi, i jepet plot pekule parcela ndërtimore.

Të nderuar deputetë, jemi në kushtet kur nuk kemi akoma një afat kohor se kur do të marrin paratë pronarët që shpronësohen për efekt të ligjit të legalizimeve. Qeveria shqiptare është me duar të lira dhe nuk i thotë gjë kurrkush që ka shkelur ligjin në qoftë se nuk i jep qoftë edhe gjysmë leku atyre personave, sepse i tillë është ligji. Të tillë e ka bërë ligjvënësi shqiptar, sepse ashtu i interesonte dhe të tillë po e mban ligjvënësi sot, sepse ashtu i intereson.

Për të ardhur te rastet e veçanta te neni 35. Neni 35 parashikonte që pronarit të tokës nuk i bëhej legalizimi në qoftë se në atë zonë parashikoheshin ndërtime mbi 5 kate. Personit që kishte ndërtuar në një vend ku parashikohej që do të ndërtoheshin objekte mbi 5 kate nuk i legalizohej objekti, por ai do të përfitonte banesë sociale. Ky ishte ligji. Më vonë ligjvënësi i nderuar në vitin 2009 dhe në vitin 2010 e ndryshoi dhe tha: “Procesi i legalizimit ku parashikohen ndërtime mbi 6 kate nuk do të bëhet, por pronari i truallit bashkë me investitorin janë të detyruar t’i japë strehim atij personi që ka ndërtuar pa leje në tokën e tij sipas normave për frymë që ka strehimi në Republikën e Shqipërisë (rreth 12 metra katrorë, në mos gaboj). Pra, mori një detyrim, që e kishte shteti për t’i furnizuar me banesa sociale. Ç’bëri? As më shumë e as më pak, ia ngarkoi këtë detyrim pronarit të truallit, se mban pronari i truallit.

Te projekti i ri që keni futur, nuk jeni mjaftuar vetëm me kaq, por keni shtuar edhe diçka tjetër, “jo më pak se 80 metra katrorë”. Pse duhet ta bënit këtë?

I vetmi nen që nuk ka ndryshuar në të gjithë projektligjin, nga 2006-a e deri sot, është neni 39 (në mos gaboj), që parashikon se nuk bëhet procesi i legalizimit kur parashikohen

projekte infrastrukturore. Ishte një pozicion që atëherë shteti e mbajti me forcë, që të mos paguante para dhe tha se nuk bëhet legalizimi. Këtë pozicion po mban edhe sot e kësaj dite.

Po mirë, shteti paska të drejtë të thotë se nuk ta jap këtë sipërfaqe toke dhe nuk do të bëhet legalizimi! Po pronarit të truallit pse ia ngarkoni gjithë këto gjynahe mbi kurriz?! Pse ia ngarkoni edhe këta 80 metra katrorë? Sepse ato para ai nuk ka për t'i marrë asnjëherë nëse tërhiqet nga kjo e drejtë, paratë e kompensimit, që do t'i ofroni ju, sepse i tillë është ligji, nuk kanë afat kohor.

Kam edhe diçka të fundit. Ndoshta u bëra i bezdisshëm për veshët e dikujt, por do të më falni, se kjo është puna dhe detyra ime dhe këtë do të bëj.

Po marr një rast tjetër klasik. Po përmend “Astirin”, pa dashur të ngre ndonjë paragon tjetër. Te “Astiri” janë ndarë toka me 452-shin, me vendimin e Këshillit të Ministrave për ndarjen e tokave të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe një person ka përfituar tokë rreth 2500 metra thjesht për faktin se ka qenë punonjës i ndërmarrjes bujqësore në atë vend, në rastin më të mirë. Atëherë i dhamë tokë bujqësore me ligj, por sot ai person, në rastin më të mirë, do ta japë për ndërtim pallatesh atë 2500-metërshin dhe, në rastin më të keq, në qoftë se do të kompensohet, sepse është zënë toka me ndërtime pa leje, do të marrë 300 mijë lekë për metër katror. Rasti i “Astirit” është 330 mijë lekë për metër katrorë. Ka marrë një tokë pa para thjesht për faktin se ishte punonjës i ndërmarrjes. Ai e mori si tokë bujqësore dhe sot shteti po ia kompenzon si tokë truall.

Ç’ndodh me pronarët shqiptarë? Sipas ligjeve, deri në 2013-n pronarit shqiptar i është dhënë një tokë, që është emërtuar truall. Ka një vendim të Komsionit të Kthimit të Pronave, që do të kompensojë një tokë truall. Me ligjin e famshëm nr.133 ndryshoi skema dhe i thuhet pronarit: “Unë do të t’i jap paratë e kompensimit, por sipas zërit kadastral që ka pasur toka në momentin e shpronësimit”. Pra, pronarin e kthen 70 vjet mbrapa në të drejtën e pronësisë, kurse këtij (më falni për shprehjen) cingut të ri, që e ka marrë tokën me 7501-shin, ia dhamë të gjithë bashkë tokën si tokë bujqësore dhe sot po ia shpronësojmë për tokë truall.

Pse dy standarde? Një standard për pronarin e truallit dhe një standard tjetër për atë tjetrin?

Unë e kuptoj që 6/1-shi i bie ndesh ligjvënësit shqiptar. Kur themi 6/1-shi, e kam fjalën për nenin 6/1 të ligjit nr. 133, sepse neni 6/1 krijoi mundësinë e ulës së faturës, që ishte fatura e 24 mijë vendimeve për kompensim. Ligjvënësi shqiptar ka publikuar nëpërmjet Agjencisë së Trajtimit të Pronës një vlerësim prej rreth 600 milionë eurosh. Pra, nga 5 miliardë euro fatura u ul në 600 milionë euro. Ky nuk është një vlerësim përfundimtar, sepse

kur bashkohen vendimet, patjetër që shuma do të ulet në maksimumin e mundshëm. Ligjvënësit aq iu desh ai nën dhe ai ligj.

Sot ai ligj i ka prodhuar efektet e tij. Edhe sikur nesër apo pasnesër të shfuqizohet nga Gjykata e Strasburgut (kjo gjë do të ndodhë), për ligjvënësit shqiptarë nuk ka rëndësi, sepse ata thonë: “Ne me ligj po ecim deri sot. Kur të mbarojë kjo, në mos ne, ata të tjerët që do të merren mbas nesh, do të bëjnë një ligj tjetër, për të krijuar një skemë tjetër të kompensimit të pronarëve, por paratë ama, pronarët nuk kanë për t’i marrë asnjëherë.”

E njëjta skemë është edhe ajo e ligjit nr. 133 dhe po zbatohet me këtë ligj të ri, falë ligjit për legalizimet.

Zotërinj deputetë, në mos ju, të tjerë mbas jush do të vijnë dhe do të diskutojnë po të tilla gjëra. Kjo çështje nuk është mbyllur, por po hapet.

Më vjen shumë keq, sinqerisht, që po kalon një projektligj i tillë, që nuk i shërben përmirësimit të punës! Unë e kuptoj që është e drejta e shtetit shqiptar të mbyllë gjithçka, por jo në këtë formë. Mos mendoi se do t’i vini kapak tani dhe, mbasi t’i keni vënë kapakun, do të filloni t’i tregoni gjërat siç kanë qenë më përpara.

Faleminderit për kohën që më dhatë!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zoti Vorbsi!

Ne e kemi diskutuar çështjen e pronave prej shumë vitesh, të paktën qëkurse unë jam në këtë komision.

Fatkeqësisht, jemi në një stad ku, nga 91-shi, kur nis edhe zanafilla e të ashtuquajturës zgjidhje, procesi është komplikuar. Një akt ligjor apo një akt nënligjor ka ardhur duke e komplikuar çështjen, në vend që ta zgjidhë atë, aq sa sot unë besoj (ky është opinionimi im) se jemi përpara një nyjeje gordiane, të cilën të gjitha qeveritë e mëparshme, përveçse e kanë komplikuar, nuk e kanë shtjerrë apo...

A është kjo zgjidhja më e mirë? A është ajo që duhet? Pikërisht për këtë jemi duke diskutuar tani, duke parë edhe propozimet.

Një gjë është e vërtetë dhe duhet ta pranojmë: kemi përpara një lëmsh të krijuar përgjatë 20 e ca vjetëve. Shkokolepsët lëmshi apo pritët nyja gordiane... Kjo e dyta duket pak më e mundshme të ndodhë. E para është provuar që nuk ka ndodhur.

Gjithsesi, ju falënderoj për shqetësimet që sollët në komision!

Nga grupi i Shoqatës së Gjeodetëve, Bledi, Romeo, kush do të falsë?

Atëherë, kemi këtu zotin Nazarko, të cilit i uroj mirëseardhjen në komision! Zoti Nazarko përfaqëson Shoqatën e Gjeodetëve Shqiptarë.

Do të donim të dinim opinion tuaj për ligjin. Jam vënë në dijeni që ka një depozitim me shkrim të sugjerimeve për ligjin.

Pas zotit Nazarko, a ka ndonjë grup tjetër, përveç atyre që i kanë çuar me *e-mail*?

Do të doja të zbardheshin edhe këto mesazhet, ai adresuar me *e-mail*, ai me mesazh dhe ai që ka ardhur në faqen... Të zbardhen dhe t'u vendosen deputetëve.

Kemi edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Bujqësisë, që kanë disa komente për të bërë. Këtu shoh edhe zëvendësministren, të cilës i uroj mirëseardhjen!

Kemi përfaqësuesen e ALUIZNI-t, si dhe një sërë propozimesh për ndryshimin e ligjit, që kanë ardhur pas bisedave që kemi bërë me relatorët.

Ministria e Bujqësisë e ka me shkrim.

Kemi edhe një draft të propozimeve të grumbulluara, të cilin do ta vëmë në dispozicion të deputetëve.

Ora është 11:45. Në orën 12:30 kemi një takim tjetër të rëndësishëm, të paktën disa prej deputetëve. Kjo do të thotë që do të bëjmë pjesën e parë të dëgjësave dhe pastaj do të vazhdojmë në aktivet dhe do të mbetemi në kontakt për të diskutuar.

Komision përgjegjës është Komisioni i Ligjeve. Si rregull parlamentar, Komisioni i Ligjeve apo komisioni përgjegjës është ai që bën diskutimin e palëve dhe të grupeve të interesit. Gjithsesi, ky komision ka qenë gjithmonë i hapur dhe gjithkush është i mirëpritur për komente.

Duhet t'ju them se në orën 12:25 duhet të shkëputem, së bashku me 2-3 kolegë, për një takim që kemi aranzhuar ditë më parë.

Fjala është për zotin Nazarko. Më pas do të dëgjojmë përfaqësuesit e Ministrisë së Bujqësisë, si dhe do të lexojmë propozimet që kanë ardhur nga individë të ndryshëm. Kemi edhe draftin tonë, të cilin do t'ia vëmë në dispozicion Ministrisë së Drejtësisë dhe ALUIZNI-t, për të parë ku konsistojnë ndryshimet që kemi propozuar.

A jeni dakord, të nderuar kolegë?

Zoti Nazarko, fjala për ju.

Romeo Nazarko- Përshëndetje, i nderuar kryetar!

Përshëndetje, të nderuar anëtarë!

Ju falënderojmë që na dhatë mundësinë të diskutojmë për projektligjin për kadastrën dhe projektligjin tjetër, një projektligj i iniciuar në vitin 2014 nga Shoqata e Gjeodetëve të Shqipërisë! Këtë do ta tregojmë edhe më poshtë me dokumentacionin përkatës.

Do të bëj një prezantim të shkurtër.

Shoqata e Gjeodetëve të Shqipërisë është një grup interesi (që të mos përdorë fjalën shoqatë, se është abuzuar shumë me këtë fjalë), që është krijuar për të mbrojtur interesat e gjeodetëve dhe të profesionit të gjeodetit. Është krijuar në vitin 1991, kur ministër i asaj kohe ka qenë Ismail Ahmeti. Më vonë janë bërë ndryshime në strukturën e kësaj shoqate vit pas viti, të cilat janë regjistruar në gjykatë.

Për projektligjin në fjalë ne kemi pasur kontestimet dhe qëndrimet tona, të cilat i kemi paraqitur me shkresë.

Ky projektligj bie ndesh me parimet kushtetuese të Republikës së Shqipërisë dhe konkretisht me nenin 11, pika 1, sipas të cilit sistemi ekonomik i shoqërisë bazohet në lirinë dhe veprimtarinë e ekonomisë.

Dispozita të caktuara të këtij ligji cenojnë rëndë këto parime kushtetuese, duke kufizuar lirinë e veprimit ekonomik dhe duke cenuar kufizimin e të drejtës së ushtrimit të profesionit të lirë inxhinier gjeodet në Shqipëri.

Dispozitat që shkelin këtë parim kushtetues janë: neni 1, neni 21, neni 30, neni 36 e të tjerë të projektligjit për kadastrën, që sjell cenimin e ushtrimit të profesionit të gjeodetit.

Procesi i hartimit të këtij projektligji nuk ka respektuar dispozitat ligjore dhe parimet për njoftimet dhe konsultimin në publik, konkretisht, ligji nr.146 i 2014-s, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Te dispozitat e këtij projektligji ndërthuren kompetenca dhe parime kushtetuese të ndarjes së pushteteve, që krijojnë mbivendosje mes kompetencave të pushtetit ekzekutiv dhe atij gjyqësor, duke propozuar nene ku gjykata detyrohet të sillet në një mënyrë të caktuar dhe të marrë vendime të bazuara vetëm në dokumente të caktuara. Dispozita që shkel këtë parim kushtetues është neni 68 i këtij projektligji. Sipas këtij projektligji, të vetmit që kanë të drejtë të bëjnë verifikimin, matjen në terren, ekspertiza në gjykatë e të tjerë, janë shërbimet inxhinierike, janë vetëm punonjësit e këtij institucioni të ri të krijuar me këtë projektligj dhe asnjë ekspert i jashtëm, i cili në çdo rast është i paanshëm dhe objektiv, mund të jetë me shumë eksperiencë dhe përvojë disavjeçare, si dhe mund të realizojë oponencën, ekspertizën teknike, me objektivet, profesionalizëm dhe paanësi.

Për sa më sipër, dëshiroj t’ju paraqes një panoramë të marrëdhënieve institucionale midis shoqatës sonë dhe institucioneve publike shqiptare.

Nga shoqata jonë ka pasur gjithmonë korrektësi dhe vëmendje maksimale, duke qenë se anëtarët e kësaj shoqate janë në koherencë të këtij procesi të rëndësishëm që po kalon vendi ynë dhe janë në dijeni të problematikave, që shqetësojnë të gjitha palët e interesuara në këtë proces.

Për këtë arsye, herë pas here kemi bërë propozime konkrete, duke synuar zgjidhjen e këtij problemi dhe të kësaj situatë.

Konkretisht, Shoqata e Gjeodetëve të Shqipërisë është njohur në rrugë informale me draftin e projektligjit për kadastrën. Me sa kemi dijeni, draftimi i këtij projektligji ka filluar që në shtator 2018, por shoqata jonë nuk është njoftuar asnjëherë për këtë nismë ligjore, edhe pse ne u jemi drejtuar disa herë institucioneve draftuese, për të qenë palë dhe kontribues në draftin e këtij ligji.

Eksperienca e anëtarëve të kësaj shoqate do të ishte një vlerë e shtuar në procesin e hartimit të kësaj nisme ligjore, duke pasur parasysh eksperiencën disavjeçare në institucionet shtetërore, tashmë edhe në sferën private.

Shoqata e Gjeodetëve ka dhënë kontribut të rëndësishëm dhe herë pas herë u ka dërguar zyrtarisht mendime dhe sugjerime institucioneve shtetërore. Duhet përmendur shkresa nr. 52, datë 07.01.2014, ku ne i jemi drejtuar Kryeministrit, gjithë ministrave të linjës, përfshirë edhe Ministrinë e Drejtësisë, ku kjo shoqatë ka bërë propozime në vitin 2014, në bashkëpunim edhe me shoqata të tjera. Konferenca është zhvilluar në bashkëpunim me Shoqatën e Arkitektëve të Shqipërisë, Shoqatën e Vlerësuesve të Pasurive të Paluajtshme, Shoqatën Shqiptare të Inxhinierëve Konsulentë, Shoqatën Pronësi me Drejtësi, si dhe me Shoqatën e Gjeoteknikëve të Shqipërisë.

Te pika 2 kemi propozuar unifikimin e sistemeve të regjistrimit dhe hartave midis gjithë institucioneve (ZRP, AKKP, ALUIZNI e të tjerë); koordinimin dhe kontrollin në fushën e punimeve topografike, hartografike dhe gjeodezike; përdorimin e hartave të unifikuara dhe të zyrtarizuara (dokument që e kemi bashkëngjitur).

Shoqata jonë, duke dashur gjithmonë të japë kontributin e saj në çështje teknike lidhur me problematika për të cilat anëtarët e saj janë ekspertë, ka nënshkruar edhe një memorandum mirëkuptimi me Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe Turizmit më 19.03.2014, ku në pikën 12 thuhet shprehimisht: “Ministria është e gatshme të konsultohet me shoqatën tonë gjatë procesit të hartimit dhe të marrë mendimet tona për çdo akt ligjor dhe nënligjor, që do të iniciohet në fushën e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit, administrimit të tokës, turizmit, legalizimit të shtesave me leje dhe pa leje, me objekte me leje”.

Ky është memorandum i bashkëpunimit midis Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Shoqatës së Gjeodetëve, të cilin Shoqata e Gjeodetëve është munduar ta zbatojë korrektësisht. Nga pala tjetër nuk kemi marrë asnjë sinjal.

Komunikimi zyrtar nga ana jonë ka vijuar duke pasur si synim administrimin e procesit dhe krijimin e një baze ligjore të mirëzbatueshme nga të gjitha palët.

Me shkresën nr. 78, datë 15.07.2014 i jemi drejtuar zotit Artan Lame, ku i kemi propozuar një projekt konkret, i cili, sipas nesh, do të ndikonte në përmbylljen me sukses të procesit të legalizimeve. Bashkëngjitur kërkesës është edhe projekti.

Në lidhje me projektligjin në fjalë, në asnjë rast shoqata jonë nuk u vu në dijeni në lidhje me nismën ligjore që ishte ndërmarrë për hartimin e tij. Pra, minimalisht nuk janë respektuar dispozitat e ligjit nr. 146 të vitit 2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Me gjithë insistimin e herëpashershëm për të dhënë kontributin tonë teknik, kontributi ynë nuk u kërkua. Është i paqartë fakti nëse ky projektligj është mbështetur në ndonjë model european, i cili është mirëfunksional dhe për hartimin e të cilit kanë asistuar ekspertë të huaj. Direkt, pasi jemi vënë në dijeni, kemi kërkuar ligjin “Për kadastrat”. Siç është ASHK-ja, që pretendohet të krijohet, është edhe AKK-ja, që është Agjencia Kadastrale e Kosovës, një ligj i cili nga pamja e parë i plotëson të gjitha problemet teknike dhe ligjore në Shqipëri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund t’jua vëmë në dispozicion.

Në formatin që kemi parë mendoj se e kanë marrë si fillim dhe pastaj e kanë ndryshuar në nenet vijuese. Megjithatë, shoqata jonë, duke pasur parasysh rëndësinë që paraqet ky projektligj, po ju paraqet propozimet konkrete, të cilat duhet detyrimisht të merren parasysh, pasi në rast të kundërt miratimi i këtij projektligji, me dispozitat siç është hartuar, do të sjellë ngërç institucional ndërmjet kompetencave të zbatueshmërisë së tij nga ana e gjyqësorit dhe paanshmërisë së vendimeve të gjykatës, si dhe ekspertizës së pavarur që duhet të depozitohet rast pas rasti në gjykatë, si dhe në mirëfunksionimin e profesioneve të lira dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike të të gjitha profesioneve në Shqipëri.

Shoqata e Gjeodetëve të Shqipërisë ka bindjen se me ndryshimet dhe propozimet që ka dhënë shmanget këto problematika të evidentuara nga ana jonë.

Propozojmë të jemi palë dhe bashkëhartues në këtë nismë ligjore, pasi sjellim një eksperiencë dhe ekspertizë, e cila do të jetë vlerë e shtuar në këtë proces tejet të rëndësishëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, më jepni kohë të lexoj edhe sugjerimet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Një sekondë, për ta bërë pak më të thjeshtë dhe më të kuptueshme për kolegët, pra pa lexuar një shpjegim, na thoni si është dhe si propozohet, por e thënë thjesht. Pra, në ligjin aktual, ku hyn roli i gjeodetit dhe si e mendoni ju që duhet të jetë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë i mungon ligjit dhe çfarë propozoni ju? Por kjo e thënë pak më thjesht.

Romeo Nazarko – Do të bëj dy propozime, jo një.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E para, ku hyn roli i gjeodetit dhe, e dyta, në lidhje me kadastrën.

Që të thuash kadastrë, duhet të marrësh parasysh që ke të bësh me gjeodezi në pjesën më të madhe të të gjithë procesit, sepse ne mund të bëjmë një ligj kadastral në aspektin ligjor, por nuk do të arrijmë të zgjidhim pjesën kadastrale në aspektin teknik (hartat).

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Situata hartografike në Shqipëri, ashtu siç është përmendur edhe nga hartuesit e ligjit, është tejet e rënduar dhe besoj se për këtë biem dakord të gjitha palët. Është një situatë që, në qoftë se do të vazhdojmë në të njëjtën gjendje, do të shkojë keq e më keq. Për këtë arsye ne do të duhet ta nisim procesin nga zgjidhja hartografike, për të vijuar me pjesën ligjore.

Në momentin që mbi tavolinë do të kemi një zgjidhje të problemit hartografik, atëherë mund të mendojmë për një zgjidhje ligjore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka argumente të shtuara, por po ju them se asnjë institucion... Procesi nuk ka ngecur në aspektet ligjore, por vetëm në aspektin teknik.

Janë munduar gjithmonë t'u japin zgjidhje të pjesshme, por këto zgjidhje nuk kanë funksionuar. Për këtë unë kam VKM-të e bëra vit pas viti, ku pjesën hartografike ia japin shtetit, një herë në bashkëpunim me shtetin, por asnjëherë nuk e kanë zgjidhur. Të mos shkojmë më larg, por le të marrim rastin e Maqedonisë, ku procesi i legalizimit është në fazat përfundimtare, ama përfundimtare-përfundimtare, jo siç theksohet në procesin tonë, që jemi drejt mbylljes, por statistikën që janë në letër nuk vërtetohen. Aty pjesën teknike e bëjnë inxhinierët privatë, të cilët përgatisin të gjithë dosjen e subjekteve. Shteti administron, kontrollon kompanitë dhe inxhinierët gjeodetë të licencuar. Në këtë rast shteti merr përsipër të bëjë të gjithë procedurën teknike.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kështu po e bëjmë.

Eduard Shalsi – Si keni vepruar në të kaluarën?

Edhe një herë për kolegët: merret përsipër nga agjencia e re shtetërore që të bëjë dhe të ekzekutojë funksionin përpos të tjerave, edhe të gjeodetit. Ky është thelbi.

Ndërkohë, propozimi juaj është që këtë do ta bëjnë gjeodetët dhe agjencia do ta monitorojë. Dakord?

Romeo Nazarko – Po, agjencia do ta monitorojë, do të vendosë standardet dhe procedurat, do të kontrolloj dhe do të zbatojë.

Eduard Shalsi – Pra, ky është thelbi i ndryshimit që ju kërkoni?

Romeo Nazarko – Njëri nga ata.

Eduard Shalsi – Besoj se është më kryesori, apo jo?

Romeo Nazarko – Po, si shoqatë.

Eduard Shalsi – Pyetje: ne kemi një situatë në terren, pra kemi një realitet. Përvoja e deritanishme ka treguar që ato që ekzistojnë në letër nuk përputhen me ato që ekzistojnë në realitet. Shpeshherë, pjesë të diskutimit të komisionit kanë qenë që teksa kërkohet të regjistroheshin pronat, paradoksalisht synohej që ato që ekzistonin në letër të përputheshin me ato që ekzistonin në realitet dhe jo e kundërta. Çfarë ndodhte? Ndodhte që kur një person kërkonte të legalizonte apo të hipotekonte diçka, shkonte në hipotekë dhe hipoteka i thoshte: kështu siç e ke sjellë ti, nuk ta bëj dot, sepse në hartë dhe në letër e kam ndryshe, prandaj shko dhe përputhe pak me këtë që kam unë, në mënyrë që ta regjistrojmë. Ky ka qenë një debat shumë i madh.

Brunilda, mund të përfshihesh dhe të ulesh atje!

Pra, një nga problemet më të mëdha që të paktën unë kam konstatuar, ka qenë që nuk është tentuar të shkojë realiteti te hartat, por është tentuar, që të shkojnë hartat te realiteti, gjë që ka shkaktuar një mospërputhje dhe një mosekzekutim të shumë vendimeve.

Pjesë e problematikës kanë qenë shumë hallka, njëra prej të cilave ka qenë edhe hallka e atyre që bënin matjet. Duke qenë se paguheshin nga subjekti, letrat e aktualitetit i bënin shpeshherë për t'i përputhur me hartat në hipotekë.

Thelbi i procesit është ky: ne kemi një realitet, që e kemi fotografuar dhe e kemi të qartë se si është. Ndërkohë, na duhet që këtë realitet ta përputhim me atë që ekziston nëpër harta dhe nëpër regjistra. Nuk mund të nisemi se çfarë thotë harta dhe kur shkojmë në realitet, të shohim që nuk është. Pra, duhet të bëjmë të kundërtën e asaj që kemi bërë deri tani, që ka bërë që procesi të ngecë, apo jo?

Si kërcënohet ky proces? Nëse ky ligj e pengon të bëhet një gjë e tillë, sipas asaj që thoni ju dhe sipas propozimit tuaj që roli i gjeodetëve nuk është ai që duhet të jetë. Nëse e kuptojmë drejt, nuk është se hiqet roli i tyre, por thjesht institucioni merr përsipër ta bëjë një gjë të tillë.

Pyetja që kemi ne si ligjvënës, duke dëgjuar grupet e interesit, agjencitë dhe gjithkënd, është, nëse e bën më mirë shteti apo privati? Deri më sot të dyja kanë dështuar ta bëjnë.

Ne kemi marrë një raport të gjeodetëve të certifikuar me prona, të cilat nuk e sjellin në realitet, por e sjellin në hartë. Nuk e di sa masive është kjo dukuri (ndoshta jo për faj të tyre),

por ka një mospërputhje që vjen nga mekanizmi i paqartë që ka ekzistuar deri tani. Këtë rol dua ta sqaroni pak më mirë. Para se t'ju jap fjalën, relatorja, zonja Gjermani, ka një ndërhyrje.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, kryetar!

Unë ju dëgjova me vëmendje, mbajta shënime, shikova problemet që mund të ketë projektligji ekzistues dhe si mund t'i përmirësojmë ato.

Gjatë fjalës suaj më bëri përshtypje kur përmendët marrëveshjen që kemi lidhur së bashku, kur unë kam qenë ministre e Zhvillimit Urban dhe Turizmit. Unë besoj se ajo marrëveshje është realizuar, pasi ju keni qenë pjesë pothuajse e të gjitha tryezave që ministria ka realizuar, ku ju është marrë mendim për çdo projektligj që kemi diskutuar dhe besoj se kemi pasur një model bashkëpunimi dhe nuk mund të thoni që nuk ka përgjigje. Ministria e Zhvillimit Urban nuk ekziston më, por minimalisht, kur jepni sugjerime sesi mund të përmirësohet puna si grup interesi, duhet të përmendni edhe vlerat pozitive, më vjen keq për këtë. Sot isha e pranishme unë këtu, por, normalisht, duhet të jemi të saktë për ato që themi.

Romeo Nazarko – Për shkak të moshës që kemi, ne jemi të gjithë të rinj dhe vit pas viti do të jemi prapë ne ata që do të diskutojmë.

Në lidhje me marrëveshjen e bashkëpunimit, ishte dëshira e mirë e Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe e shoqatës për të krijuar një marrëveshje, por pas firmosjes së marrëveshjes asnjë nga institucionet që ishin në varësi të ministrisë nuk... Unë për të qenë i hapur me ju, sot kam marrë edhe librin e protokollit të Shoqatës së Gjeodeteve, ku janë të gjitha shkresat nisur institucioneve dhe nuk ka asnjë përgjigje nga ana e tyre. Nuk dua të fajësoj ministrinë lidhur me këtë çështje, por fajësoj institucionet e varësisë, drejtorinë e legalizimit, zyrën e regjistrimit dhe të gjitha institucionet e varësisë, të cilat, pavarësisht kërkesave tona konkrete, nuk kanë denjuar t'u kthejnë përgjigje shkresave tona.

Edhe në lidhje me kërkesën për t'u bërë pjesë e këtij projektligji, pasi projektligji u dorëzua në Kuvend në datën 28, në mënyrë urgjente u dërgua pranë shoqatës në datën 5.

Rakip Suli- Konkretisht, çfarë ju shqetëson ju si shoqatë dhe ku e prek ky projektligj shoqatën tuaj?

Brunilda Laze – Kadastra është e përbërë nga hartat dhe regjistrat e saj. Ku është harta në rastin konkret?! Nuk është. Në këtë projektligj, nga fillimi deri në fund, nuk është përmendur në asnjë rast se çfarë është një hartë kadastrale, kush e përpilon hartën, çfarë sistemi përdorin dhe si u jepet zgjidhje problemeve kadastrale.

Kalojmë te pyetja e zotit Shalsi. Kemi terrenin dhe hartën dhe kemi probleme me mbivendosjen, ku u duk sikur problemi krijohet vetëm nga mospërputhja e të dyjave. Jo, fajet i kanë hartat që përdoren sot dhe janë ligjore. Nga këndvështrimi hartografik, merret fotografimi ajror, bëhet harta, konsulat e çdo pallati bien mbi rrugë dhe, kur ata bien mbi rrugë, nuk quhet ndërtim, sepse humbet trotuari dhe rruga. Ti po e shikon rrugën nga fotografimi dhe nuk po bën matje praktike në terren. Ne po flasim për qytetin, aty ku rruga nuk është te rruga, trotuari nuk është te trotuari ku fizikisht janë. Pra, që kur ti po e përpilon këtë hartë (flas çfarë është bërë deri tani) e ke të gabuar, sepse nuk ke një sistem koordinate që punon, nuk ke matje faktike në terren, gjithmonë po ligjëroi ortofoton. Ortofotoja është e gabuar. Ortofotoja është orientuese, por nuk është definitive, prandaj nuk duhet të marrim atë, kjo është për pjesën e qytetit.

Vijmë te fshati: hartat 5-mijëshe u bënë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me ato është punuar, por nuk është e saktë ortofotoja, është orientuese. Është një element orientues për ta kuptuar shumë mirë ata që nuk janë profesionistë se ku pozicionohet një pronë në mënyrë gjeografike, por për matje faktike në terren ortofotoja nuk mund të përdoret.

Eduard Shalsi – Ju thatë sistem orientues, pra nisesh nga ortofotoja...

Me sa kam dëgjuar dhe me aq sa kemi debatuar, nuk më duket, ortofotoja vazhdon të jetë orientuese, por që shoqërohet edhe me tjetrën.

Person - E keni në një pikë të ligjit, që nuk është orientuese, por e keni përcaktuese. Ajo duhet marrë për bazë.

Eduard Shalsi – Po, pra duhet të nisesh nga harta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Robert Bitri – Në hipotekë që të gjithë ata që kanë bërë privatizimet e viteve '90 sot ankohen se sipërfaqja reale, që ata kanë privatizuar, mund të jetë diçka më e madhe ose diçka më e vogël, por ata kanë privatizuar një sipërfaqe dhe thonë se në hartë nga fotografimi del kështu. Realiteti është ai që është.

Person – Duhet matur.

Robert Bitri – Është ajo që ne e bëjmë me matje, një metër, pra fotografia tregon se kjo ndodhet këtu, por jo saktësisht sa metra është.

Eduard Shalsi – Zoti Bitri, edhe një herë, debati për të cilin ne si ligjvënës duhet të sqarohemi ka të bëjë me faktin se kemi një armatë gjeodetësh, profesionistë të organizuar në një shoqatë dhe kemi një propozim që këtë gjë mund ta bëjë një agjenci shtetërore.

Domethënë, ne duhet të bindemi, të paktën unë, por edhe ju, përpara se të marrim vendimin nëse është pikërisht kjo gjë: e bën dot agjencia apo e bën dot shoqata? Kemi dëgjuar një palë, që thotë nuk ka nevojë, mund ta bëjë një agjenci e organizuar me gjeodetët e saj. Nga ana tjetër, kemi shoqatën që thotë jo, ne nuk mendojmë se mund ta bëjë një agjenci. Ky është thelbi i debatit?

Romeo Nazarko – Po.

Robert Bitri – Unë nuk jam dakord që nuk e bën dot agjencia...

Eduard Shalsi – Zoti Bitri, edhe një herë për racionalitet, sepse po bëjmë disa diskutime dhe ne e dimë shumë mirë, të paktën ne, me përjashtim të atyre që janë specialistë, se nuk mund të bëhemi specialistë të njëres dhe të tjetres. Sot që flasim unë po konsolidoj bindjen, pra debati që po shtrohet është ky: a duhet të përfshihet privati në një proces të tillë, apo mund ta bëjë agjencia shtetërore? Kjo është ajo që kuptoj unë. A ka ndonjë që nuk e kupton kështu?

Urdhëroni, zoti Bitri!

Robert Bitri – Mendoj se nuk ka rëndësi se cili e bën, privati apo një agjenci e mirorganizuar. E rëndësishme është se në qoftë se kjo agjenci e mirorganizuar do të thotë se patjetër duhet të ketë gjeodet, pra në finale duhet ta bëjë specialisti, jo çdo njeri që mund të bëjë një hartë. Gjithmonë, ne kërkojmë inxhinier dhe specialist, prandaj edhe kur bëhet gjyqi, kur shkohet në gjyq thuhet: “Po, unë dua një gjeodet me licencë, i cili do të më saktësojë hartën, pozicionin”. Kjo nuk ka rëndësi. Kjo është formë organizimi, por e rëndësishme është një gjë, që ai do të vendosë firmën përfundimtare në një hartë, duhet të jetë gjeodet.

Eduard Shalsi - E qartë.

Po, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj - Me sa kuptoj, nuk është problemi që ta bëjë agjencia publike apo do ta bëjnë profesionistë të lirë të licencuar. Unë më shumë kuptoj se cili do të jetë instrumenti me të cilin do të arrijmë aty. Komenti i parë që u bë ishte: fotografimi ajror është indikativ, por lë hapësirë për evazivitet, po them fjalën më të lehtë. Edhe kjo varet shumë nga çfarë teknologjie përdor, se po flasim për ditën e parë. Pastaj kur të jetë e gjitha në vend, do të jetë shumë më e lehtë. Pse e mora këtë? Nëse në vitin 2008 aeroplani që bëri fotografimin ajror fluturoi nga këtu, vetvetiu dha shmangie dhe e quante nga këtu deri aty kufi prone.

Në fotografimin e vitit 2015 aeroplani fluturoi shumë më ulët, të paktën në terma reference kur u hap tenderi, ishte një kompani gjermane, nuk e di, por kur u hap tenderi u kërkua që të fluturonte sa më ulët në mënyrë që këtë këtu ta kishte sa më të ngushtë. Sot që flasim apo në vitin 2019 me drone saktësia shkon edhe më tepër, shkon më pak se një pllakë,

gjithmonë nga fotografimi ajror. Pra, nga fotografi ajror i vitit 2019 mund të vijë ndonjë gabim një marzh i pranueshëm aq sa ka edhe instrumenti me sy, sepse edhe ai instrument është, ka gabimin e tij.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, a ka mundësi të mbaroj?

Çdo instrument në botë shkon dhe kolaudohet. Nëse e mban në makinë edhe ai një herë në 6 muaj do kolaudim.

Eduard Shalsi - E qartë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj - Atëherë, pse ndërhy?

Kjo është, por sigurisht që konflikti ka qenë shumë më i madh se para 20 vjetësh, qyteti 1 me 4 mijë, fshati 1 me 10 mijë edhe me hartat dikur që e bënë profesionistët, dilte në fund të vitit se varet nga shkalla e saktësisë që përdoret në hartë. Por me atë që u tha këtu, të paktën minimalisht ligji është përpjekur në përkufizime që të mos e shmangë hartën.

Neni 3, pika 2 “Të dhënat kadastrale”.

“Të dhënat kadastrale quhen dokumentet zyrtare që krijojnë pronësinë mbi një pasuri, hartat topografike dhe informacioni gjeografik që tregon vendndodhjen e pronës, si dhe vlerën monetare...” Pra, hartë topografike, informacion gjeografik. Para 30 vjetësh ne nuk flisnim për koordinata gjeografike në hapësirë, sepse nuk e dinim si koncept. Hartë e kishim. Sot ka x, y me detaje. Këtu, sot që flas unë, po të jap vendodhjen ku jam dhe e kam shumë më të saktë se çdo lloj harte që mund të bëni ju apo fotografim që mund të bëhet nga lart.

Nëse gjykoni që përkufizimi i hartës është i paplotë, atëherë duhet ta zgjerojmë. Ne nuk bëjmë ligje me qëllimin si t’u japim punë disa profesionistëve, por qëllimi ynë është saktësia, pastaj instrumenti me të cilin arrihet dhe kush është institucioni që e arrin, ky është momenti i dytë.

Faleminderit!

Romeo Nazarko – Po e nis këtu ku e la zoti Beqja.

Për sa u përket fotografimeve ajrore të bëra në vitet 2007 dhe 2015, sigurisht që fotografimi i vitit 2015 është më i saktë, por ai ka një problem se është bërë në kohën kur kanë çelur gjethet dhe nuk merren elementet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Të lutem, lëreni të mbarojë.

Romeo Nazarko – Nëse marrim një zonë të fotografuar në vitet 2007 dhe 2015, do të shikojmë që në vitin 2015 zona është e mbuluar me gjethe dhe ne nuk marrim dot asnjë element topografik në atë terren. Ky është problemi.

Për sa i përket pretendimit se kush do ta bëjë gjeodetët e shtetit apo të privatit, ne nuk jemi kundra që ta bëjnë gjeodetët e shtetit, por unë do të jap disa argumente që gjeodetët privatë e bëjnë me kosto më të ulët se ata të shtetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduad Shalsi – Të lutem, mëni të mbarojë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Robert Bitri – Më falni, zoti kryetar!

Të gjitha këto gjëra janë bërë me tenderë dhe me specialistë që kanë pretenduar që kanë pasur një licencë...

Në tender është kërkesë kryesore që ai që do të vinte të ishte specialist dhe duhet të kishte një licencë, të pëlqen apo jo.

Nuk ka rëndësi kush i bën, por fakti që këto u bënë do të thotë që këtu varet nga ajo çfarë ti do, çfarë kërkon dhe si e kërkon, pastaj të tjerat...

Eduard Shalsi – Zoti Bitri, të bëjmë një pakt, ne i kemi thërritur për të thënë opinionin e tyre sesi e mendojnë, pastaj neve na takon të gjykojmë nëse bindemi apo jo. Prandaj, zoti Nazarko, vijojeni argumenti.

Romeo Nazarko – Duke qenë se kemi qenë edhe nismëtarë të këtij projektligji, kemi kërkuar t'i bashkojmë këto institucione, sepse po e çojnë vendin në katastrofë. Për ta çliruar pak atmosferën, në gjeografinë e klasës së 7 thuhet: “Duke ditur masat e sakta të këndeve, gjeodetët mund të ndërtojnë harta, plane me një saktësi të madhe”, kjo fillon në klasën e 7 dhe vazhdon në departamentin e gjeodezisë për 5 vjet fakultet. Ne do të japim argumente dhe konkluzione konkrete se përse shteti ka dështuar në këtë proces, gjithashtu edhe për tendencën që ka draftligji në lidhje me kategorinë e punonjësve që paraqesin punën, hartën dhe të dhënat kadastrale.

Në draftligj nuk përmendet asnjëherë fjala “gjeodet”, por “specialistë të fushës”. Kush janë specialistët e fushës

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Spektori i licencimeve, licencon në fushën e gjeodezisë, gjeoinformatikën, marshoderinë e të tjera, pra janë pesë profesione që marrin të njëjtat pikë si gjeodeti. Në ligj kemi një lëmsh, sepse tenderat i bëjnë kompanitë, por punën nuk e bëjnë gjeodetët.

Më lejoni t'ju them argumentet, sepse ne pasqyrojmë të vërtetën. Në të gjithë vendet perëndimore punët në terren për matjen dhe plotësimin e të dhënave për pasurinë e paluajtshme në kadastrë, bëhen nga specialistë të licencuar në sektorin privat. Nuk ka asnjë vend ku këto punë bëhen nga specialistë të shtetit, por bëhen nga gjeodetë të licencuar, që kryejnë punën e matjeve në terren të pasurive të paluajtshme. Në vendet perëndimore ekziston profesioni, për të cilin në draftligj nuk flitet fare. Pra eliminimi i këtij profesioni nuk është një ogur i mirë, por do të ishte e udhës që në draftligj të parashikohet rregullimi i aktivitetit të këtij profesioni si nga pikëpamja ligjore, ashtu dhe ajo profesionale.

Problemi më i madh sot në administratën ekzistuese është mungesa e profesionalizmit në fushën e kadastrës. Në frymën e përgjithshme të ligjit, që është i paqartë në shumë nene, vihet re se ka tendencë që të gjitha punët të kryhen nga punonjës të administratës kadastrale apo njësisë vendore, njëlloj siç ka vepruar ALUIZNI në procesin e legalizimit të ndërtimeve informale.

Çfarë eksperiencash të hidhura kemi nga kjo lloj fryme?

- 1) ALUIZNI
- 2) Procesi përmirësim-përditësimit në ZQRPP
- 3) Procesi i konfirmimit të titujve me VKM-në nr. 994 në njësitë vendore

Procesi i legalizimit që bëri ALUIZNI, përveç faktit që u zvarrit shumë dhe nuk ka përfunduar ende, ka rezultuar me një kosto. Po të bëhet një llogaritje e thjeshtë e buxheteve që ka pasur ALUIZNI në të gjithë vitet dhe të pjesëtohet me numrin e legalizimeve që janë bërë, mund të nxjerrim një mesatare me kosto nga buxheti i shtetit me 1 mijë euro për një pasuri. Këtë kosto nuk do ta paguanin as shtetet më të pasura. Kjo është rezultat i mentalitetit se punët për matjet e pasurive në terren duhet të bëhen nga punonjës të administratës. Ky është një fakt i vërtetueshëm, përveç anës tjetër që ka stimuluar korrupsionin e punonjësve të bashkive apo të ALUIZNI-t.

Pra, rezultate negative, kosto e madhe e paguar nga buxheti i shtetit, kosto e korrupsionit e paguar nga vetë qytetarët, stimulimi i një brezi të korruptuar punonjësish në administratë, vonesë dhe zvarritje të procesit që ndodh, sepse punonjësit e ALUIZNI-t nuk kanë interes të përshpejtojnë këtë proces, por ta vonojnë me qëllim që të marrin sa më shumë bakshish, ka pasur dhe do të ketë.

Së dyti, procesi përditësim-përmirësimi në ZQRPP, që është shumë e rëndësishme. Ka 4 vjet që ZQRPP-ja mori një vendim, ku punësoi rreth 350 deri në 400 punonjës, të cilët janë ende duke punuar në funksion të përditësim-përmirësimi, rezultati deri tani është zero

për zona kadastrale të përfunduara në këto 4 vjet. Mendoni që kostoja e këtyre punonjësve mund të ketë arritur deri në 5 milionë euro.

Procesi i konfirmimit të titujve me VKM-në nr. 994 në njësitë vendore. Përpjekja pozitive e qeverisë për përmbylljen e procesit të privatizimit dhe lehtësimin e problemeve që kanë qytetarët e Shqipërisë me titujt e pronësisë që janë krijuar me ligjin nr. 7501, ka krijuar një impakt pozitiv, por nuk mund të themi që po zbatohet në mënyrë masive dhe rigoroze. Arsyeja e pengesës është mungesa e kapaciteteve dhe buxheteve në administratën e njësive vendore, si rrjedhim regjistrimi i pasurive të paluajtshme duhen bërë nga punonjësit e administratës pa pagesë. Kjo për qytetarët rezulton me dy efekte negative, nuk përballohen në kohë të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe nevojat e tyre realizohen me kushtet e bakshisheve apo pagesave nëndorë kundrejt punonjësve të bashkisë.

Si konkluzion efektet janë negative, si kostoja e lartë nga buxheti i shtetit, stimulimi i korrupsionit nga punonjësit e administratës dhe pagesa e zvarritjeve të qytetarëve. Kjo situatë do të vazhdojë nëse kjo frymë do të vazhdojë dhe nëse do të përjashtohet konkurrenca në tregun e lirë për punët që bëhen për modernizimin e kadastrës.

Ndryshimet që ne sugjerojmë të bëhen në draftligjin për kadastrën dhe që mund të rregullojë pjesërisht frymën e ligjit janë kryesisht në dy drejtime.

Të përcaktohen në ligj në një nen të veçantë që: “ASHK-ja ka të drejtën dhe përgjegjësinë për të certifikuar kompanitë dhe specialistët gjeodetë, që do të kenë të drejtën dhe besimin e zyrës së kadastrës për të kryer punët me pasuritë e paluajtshme”.

Së dyti, në të gjitha nenet ku shprehja “të gjitha punët bëhen nga punonjës të zyrës së kadastrës” duhet të ndryshohet dhe të shkruhet shprehja “në përgjegjësi të kadastrës”, sepse mund të ndodhë që mbas një viti të ndërrojë mendim dhe ne duhet të ndërrojmë ligjin që punët të bëhen nga punonjës privat. Pra ta lëmë ta vendosim më vonë nëse këto punë do të bëhen nga punonjësit e shtetit apo nga privatët.

Eduard Shalsi – Po, Brunilda, mund të flisni pak më konkretisht, sepse këto ishin pak deklarative.

Brunilda Laze – Më konkretisht do të flas për atë që tha zoti Beqaj, për të dhënat kadastrale dhe dokumentet zyrtare që krijojnë pronësi mbi një pasuri.

Hartat topografike, të vetmet harta topografike janë hartat e Institutit Gjeografik të Ushtrisë, që janë harta të shkallës 1 me 10 mijë ose 1 me 25 mijë. Pra, ky term u rrëzua

Informacioni gjeografik, do të thotë që unë ndodhem në Kuvend, por nuk kam koordinatat e sakta se në cilën zyrë jam. Pra që këtu bie edhe ky term. Në asnjë vend në të gjithë projektligjin nuk është thënë se çfarë është një hartë kadastrale, një hartë topografike

dhe cili është sistemi koordinativ. Për të matur sot kemi GPES-in, Total Station apo Teodolitin dhe Distomates për të bërë planimetritë e bëshme. Nga institucionet përkatëse që ne kemi sot, sa instrumente zotërojnë këto institucione?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, kemi harta topografike. Nuk kemi shpjegim të termit të hartës kadastrale dhe nuk e kuptojmë se çfarë është.

Po flas çfarë instrumentesh kanë sot institucionet shtetërore? Çfarë saktësie kanë? Kush merret me to? Sa të specializuar janë dhe cilin fakultet kanë mbaruar? Pra duhen kontrolluar këto specialistë.

Ne nuk kemi asnjë kundërshtie që punët t'i bëjë shteti, por ama të jenë inxhinierë gjeodetë, që përmbushin të gjitha kriteret siç i përmbush privati, dhe të licencohen sipas pikave dhe kriterëve të licencimit, por jo të jenë të fushave të tjera siç janë sot.

Një punonjës i bashkisë apo i ALUIZNI-t bën një matje në terren me distomates, mat katër brinjët e objektit, por nuk di se në çfarë sistemi koordinativ ta pozicionojë. Gjithashtu, edhe për fotografimin ajror nuk di se ku do ta pozicionojë këtë objekt. Pra në këtë projektligj nuk i kemi këto saktësime.

Vijmë te neni 1 i projektligjit, ku thuhet: “Ky ligj rregullon funksionin publik të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organizimin e institucionit përkatës për këtë funksion dhe mënyrën e administrimit të kadastrës si regjistër i pasurive të paluajtshme”. Pra flitet vetëm regjistër kadastral. Ndërkohë ne jemi shumë konkretë, “Ky ligj rregullon funksionin publik të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, matjet kadastrale, punët gjeodezike dhe kadastrale, si dhe përfitim, regjistrimin, ruajtjen, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e të dhënave kadastrale”. Përse nuk duhet të bëhet kështu? Pra, po flasim për hartë dhe për regjistër. Këto të dyja bashkë bëjnë ligjin kadastral.

Romeo Nazarko – Për ta mbyllur, në asnjë rast nuk kemi kërkuar në asnjë nen që kemi propozuar që matjet të bëhen nga inxhinierë gjeodetë privat

Eduard Shalsi – Zoti Nazarko, më thatë që është eliminuar fjala “gjeodet”. “Anëtarët duhet të kenë formim profesional të fushave të inxhinierisë, gjeodezisë, drejtësisë, ekonomisë ose administrimit publik...”. Pra përmendet te neni 8

Romeo Nazarko – Gjeodezia inxhinieri është, përse është “inxhinierisë, gjeodezisë”, pra ta lënë vetëm gjeodezisë.

Brunilda Laze – Ka inxhinierë elektrikë, pra quhen të gjithë inxhinierë.

Eduard Shalsi – Të lutem, një sekond. Brunilda a e dini se çfarë do të thotë eliminim?

Brunilda Laze – Nuk po eliminojmë ndonjë gjë.

Eduard Shalsi – A e dini ç’do të thotë eliminim? Do të thotë kur nuk ekziston fare. Te neni 8 është e shkruar “gjeodezi”.

Brunilda Laze – Kemi hequr presjen, është shumë e rëndësishme.

Eduard Shalsi – Po një sekondë, se kur thuhet “inxhinier” është term shumë gjerë, përveç kësaj specifikon edhe për gjeodezinë.

Brunilda Laze – Neni 8 është vetëm për drejtuesit.

Eduard Shalsi – Atëherë thoni ta formulojmë dhe mos thoni është eliminuar, sepse këtu thuhet fjala “gjeodezi”

Brunilda Laze – Kemi hequr vetëm presjen.

Eduard Shalsi – Te këshilli drejtues thuhet: “anëtarët duhet të kenë formim profesional” dhe fjala “gjeodet” është e shprehur.

Romeo Nazarko – Është për drejtuesin dhe këshillin drejtues.

Eduard Shalsi – Pra, folëm për këshillin drejtues dhe termi “gjeodezisë” është brenda, pra nuk është eliminuar

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë, unë mbajta shënim kur thatë që është eliminuar fjala “gjeodet” dhe po ju them se te “këshilli drejtues” dhe te “drejtori i përgjithshëm” është.

Romeo Nazarko – Vetëm te “drejtori i përgjithshëm” dhe “këshilli drejtues” është e shprehur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Nisur nga kjo, kemi bërë shtesën: “Drejtori i përgjithshëm emërohet dhe shkarkohet nga Kryeministri, ai zgjidhet nga radhët e profesionistëve të fushave...” ku ne kemi shtuar edhe gjeodezinë.

E treta, “Drejtoria vendore drejtohet nga drejtori vendor, që emërohet dhe shkarkohet nga drejtori i përgjithshëm, nga radhët e profesionistëve të fushave...” edhe këtu kemi futur gjeodezinë. Pra nuk është përjashtuar dhe nuk është eliminuar.

A mund ta saktësojmë më mirë për të hequr presjen, dy pikat, thonjëzat e të tjera, kjo duhet diskutuar, por jo të themi që është eliminuar, sepse do të thotë që nuk ekziston.

Romeo Nazarko – Në të gjitha propozimet që kemi bërë, ne nuk themi që punët të bëhen nga inxhinierë gjeodetë privatë, ne e kemi lënë “inxhinier gjeodet”, pastaj shteti ta vendosë vetë si do ta bëjë.

Shikojmë që në projektligj është parashikuar edhe data kur do të miratohet, ne si shoqatë e gjeodetëve kemi qenë dhe jemi në dispozicion për të bërë një ligj që të jetë në

interesin kombëtar. Ne jemi të gatshëm që deri më 31 dhjetor të punojmë për të bërë një ligj shumë të mirë.

Nuk e di se sa do të jetë dëshira e mirë për të bashkëpunuar.

Eduard Shalsi – Nazarko, ne kemi një problem me termin “shoqatë” dhe termin “përfaqësim”, këtë ua thashë edhe kolegëve tuaj gjatë diskutimit të paketës fiskale. Ju thatë që kishit 150 anëtarë aktivë, ndërkohë që gjeodet të licencuar nuk e di se sa ishin, por ne kemi komunikuar me 11 veta, në mënyrë rastësore dhe me përjashtim të dy individëve, të cilët dinin ligjin dhe ishin në gjendje të bënin komentet, pjesa tjetër nuk ishte në gjendje. Ky është problem dhe jo vetëm problem me një shoqatë, por është problem përfaqësimi.

Pyetja ime është: si i vendosni të gjithë anëtarët në dijeni dhe si e keni *feedback*-un nga ata, pra flisni në emër të 150 vetave apo flisni në emër të 10 apo 20 vetave? Pyetja është e sinqertë, sepse ne kishim pikëpyetje për propozimin e ardhur nga qeveria dhe pyetëm disa anëtarë të shoqatës suaj, ku pamë që një pjesë e shoqatës ishte luftarake dhe e vendosur ndërsa pjesa tjetër nuk ishte e bindur për disa çështje teknike, pra te pjesa e përfaqësimit. Pyetja është, a janë të gjithë anëtarët e shoqatës në një zë dhe si jeni të organizuar për të zgjidhur një problem, që nesër të mos na vijë emaili “x”, “y” apo “z”? Këto katër veta që kanë sjellë propozime janë me propozime konkrete, njëri është për dixhitalizimin, një tjetër është për ndryshimin e disa neneve dhe një tjetër është për disa gjëra të tjera, por nuk i janë përgjigjur pyetjes përse nuk i keni sjellë nëpërmjet shoqatës. Pra, te pjesa e përfaqësimit dua të na e sqarosh që edhe ne të jemi me koshiencën tonë të qetë që po bëjmë më të mirën.

Romeo Nazarko – Për sa i përket përfaqësimit, shoqata e gjeodetëve është e vetmja në territorin e Shqipërisë në fushën e gjeodezisë. Duke parë trendin, shoqata ka një faqe në *facebook* dhe çdo njoftim bëhet nëpërmjet tij. Kemi njoftuar të gjithë anëtarët në lidhje me projektligjin dhe nuk kemi marrë asnjë kundërshti në lidhje me pretendimet tona.

Jemi në dijeni që Komisioni i Ligjeve u ka nisur shumë grupeve të interesit, një ndër ta është edhe fakulteti, por jemi në dijeni që nuk e kanë lexuar ligjin, por kanë marrë opinion nga ne.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

150 anëtarë janë aktivë. Te gjeodetët përfshihen edhe topografët për arsye se para viteve 90 nuk kishte.

Eduard Shalsi – Faleminderit zoti Nazarko!

Jemi në limitet e kohës, prandaj përfaqësuesit e Ministrisë së Bujqësisë mund të flasin dy fjalë për shqetësimet.

Majlinda Bozgo – Mirëdita të gjithëve!

Ne i kemi sjellë edhe me shkrim komentet dhe sugjerimet që Ministria e Bujqësisë mendon që duhet të vijnë në vëmendjen tuaj, në mënyrë që të diskutohet akoma më në detaje. Ne i referohemi projektligjit për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë, që janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me tokën bujqësore.

Po përmbledh se ku konsistojnë komentet apo sugjerimet tona. Përfituesit do të jenë subjekt ose jo i ligjit kur ne jemi pro të qenurit subjekt i ligjit dhe kanë të bëjnë me resursin e tokës, sipërfaqen e poseduar mbi titull dhe plotësimin e AMTP-ve të reja. Lidhur me këto katër pika janë edhe nenet përkatëse.

Mendoni t'i kaloj shkurtimisht të gjitha nenet që ne kemi komente?

Eduard Shalsi – Nuk ka nevojë.

Majlinda Bozgo – Këto janë katër çështjet, për të cilat sugjerojmë diçka ndryshe nga projektligji aktual.

Eduard Shalsi – Dakord, meqenëse jemi në fund të mbledhjes, dua që ju së bashku me shërbimet e Kuvendit, dhe përfaqësuesin e ALUIZNI-t të uleni, për të rakorduar dhe pastaj të na prezantoni ne cili është opinionin juaj? A qëndroni në pozicionet tuaja, apo keni bërë ndonjë rakordim? Nëse do të ketë rakordim, çështja do të plotësohet. Nëse nuk do të ketë rakordim, pastaj do t'ia prezantojmë komisionit, në mënyrë që të marrë një vendim.

Kam një propozim, i cili ka ardhur në komisionin tonë. Agjencia Shtetërore e Kadastrës siguron kushtet për krijimin, regjistrimin, administrimin dhe funksionimin e të dhënave dixhitale, të pasurive të paluajtshme në sistemin e brendshëm të organizmit dhe të ndërveprimit më bazat e tjera të të dhënave shtetërore. Një nga problemet me një nga grupet e interesit kishte të bënte pikërisht me çfarë baze do të ndërtohet dhe si do të rakordohet me bazën e të dhënave të agjencive të tjera shtetërore, midis të cilat në të kaluarën sipas këtyre 6 inxhinierëve gjeodetë ka një mosrakordim, ka një moskomunikim dhe kanë sjellë këtë propozim që forcon kërkesën për mënyrë e të punuarit. Madje, krijon premisat për një VKM të posaçme për arkitekturën e sistemit softuer apo harduer, të cilat duhet të ndërtohen brenda agjencisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Propozimi është që sistemi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Propozomi është atje. Mos e bëj me VKM. Këta duan të sigurojnë që mënyra kaotike e ndërveprimit institucional të marrë fund. Nëse e bën me VKM apo nuk e bën...

Te paragrafi i fundit, pas pyetjes sime është propozimi: “Pikërisht se nuk është zgjidhur një çështje e tillë, synojmë, duke ju dhënë një shembull konkret. Një agjenci

shtetërore vijon me sistemin e vet të “*Geographic information system*”, ndërkohë që keni ndërtuar një agjenci model, të cilën nuk e keni rakorduar me këtë.” Kjo ishte e para.

Një inxhinier tjetër i vjetër në moshë propozon: “Nuk mund ta komentoj me detaje ligjin, por kam një merak. Nuk di nëse duhet ta përfshini në një ligj, mund të bëhet me VKM apo instrument ligjor. Është shumë e rëndësishme që procesi të menaxhohet dhe të drejtohet nga profesionistë të fushës. Nëse për pyjet do të vazhdoni me sociologë, tipologë të të gjitha llojeve dhe, nëse për çështje të fushës do të vazhdoni të vendosni në krye të sektorëve, të departamenteve individë që nuk kanë fare lidhje me zanatin, po ju them se, edhe nëse do ta përmirësoni ligjin, edhe nëse do ta perfeksioni atë, do të dështoni në zbatim”.

Ky është edhe një prej merakeve, pra se si do të garantojmë që këto, që kemi shkruar te pikat 3, 8 dhe 9, të ndodhin në praktikë, sepse nuk e mendojmë, jemi dëshmitarë vetë që u biem telefonave pastaj “merr filanin në punë”. Ky është një shqetësim që mbetet real për ne.

Faleminderit!

A ka ndonjë merak Ministria e Drejtësisë?

Faleminderit!

Do të njoftoheni për mbledhjen e ardhshme.

Mirupafshim!

Mbledhja mbyllet.